



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIK OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit, 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon:

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika, nenit 16, 17 c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 20 paragrafi.1 i Statutit të Komunës së Lipjanit, 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ 2023 të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM

PËR LIRIMIN NGA PAGESA E BORXHEVE TË QIRASË JOPROFITABILE TË PËRFITUESVE TË BANIMIT SOCIAL

Neni 1

LIROHEN, nga pagesa e borxheve të qirasë joprofitabile për vitin 2023 të gjithë përfituesit e banimit social që janë të vendosur në 21 banesat e ndara nga komuna, sipas Konkursit publik 1Nr.360-41414 të datës 06.07.2018 konform Vendimit përfundimtar për shpalljen e familjeve përfituese të banesave komunale sipas programit të banimit 1-360-46751 të datës 24.12.2018.

Neni 2

Lirimi nga pagesa e borxheve për përfituesit e banimit social të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi bëhet me qëllim të krijimit të lehtësirave financiare për këto familje me gjendje të rëndë ekonomike përshkak të situatës së rënduar në ekonominë e vendit si pasojë e rritjes së lartë të çmimeve të të gjithë artikujve elementar jetësor.

Neni 3

Lirimi nga pagesa e borxheve të qirasë joprofitabile për kategoritë e lartëcekura bëhet për vitin 2023 dhe përfshin periodën kohore 01.01.2023 deri me datën 31.12.2023.

Qiraja joprofitabile është llogaritur në bazë të formulës së përcaktuar me dispozitat e nenit 9 të Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit për secilin përfitues dhe mjetet që

inkasohen nga qiraja janë të hyra vetanake dhe regjistrohen në Drejtoratin për Ekonomi dhe Zhvillim në kodin 21/613/48003/50408/00000/0411 .

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Zyra e Kryetarit të Komunës – Sektori pronësor juridik.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim-Vendimi është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 paragrafi 12.2 pika, nenit 16 ,17 c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligji nr. 03/l-049 për Financat e Pushetit Lokal dhe nenit 20 paragrafi.1 i Statutit të Komunës së Lipjanit, 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Komuna e Lipjanit e konsideron të domosdoshme krijimin e disa lehtësirave financiare për këto familje me gjendje të rëndë ekonomike përshkak të situatës së rënduar në ekonominë e vendit si pasojë e rritjes së çmimeve të të gjithë artikujve elementar jetësor pasi këto familje me gjendje të rëndë sociale e kanë të vështirë në këtë situatë ti kryejnë me rregull pagesat e qirasë joprofitabile. Komuna e Lipjanit me këtë propozim –vendim kërkon nga Kuvendi i Komunës që përfituesit e banimit social të lirohen nga pagesa borxheve të qirasë për vitin 2023.

Nga të cekurat më lartë, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 400/01-2869
Lipjan, më 16.01.2023

